



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS MALISHEVË

Numri i lëndës: 2019:073633

Datë: 13.09.2021

Numri i dokumentit: 02167991

P. nr. 10/2019

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË/ DEGA NË MALISHEVË - DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI PENAL, gjyqtari i vetëm gjykues Njazi Morina, me zyrtaren ligjore Albane Morina, në lëndën penale kundër të akuzuarve: N.K., N. K., F. K., E. K. që të gjithë nga fshati M., Komuna Malishevë, me çka kanë kryer veprën penale lëndim i lehtë trupor në bashkëkryerje nga neni 188 par.1 nën par.1.4 lidhur me nenin 31 të KPRK-së (Kodi nr.04/L-082) dhe veprës penale me çka kanë kryer veprën penale sulmi në bashkëkryerje nga neni 184 par.1 e lidhur me nenin 31 të KPRK-së (kodi nr.06/L-074), dhe N.M. nga fshati A. e P., Komuna e D., për shkak të veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par. 1 lidhur me paragrafin 4.1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjakovë PP.nr. 1283/2018, të datës 11.01.2019, në shqyrtimi fillestar të mbajtur më 10.08.2021, në prezencën e prokurorit te shtetit Kastriot Memaj, të akuzuarve: N. K., F. K., E. K., **më 13 gusht 2021 nxjerr dhe publikisht shpalli këtë:**

A K T G J Y K I M

I. I akuzuari **N. K.** nga i ati S. dhe e ëma N. e lindjes B., i lindur më ..., në fshatin M., Komuna e Malishevës, me nr. personal, shqiptar, shtetas i R. së Kosovës, i martuar, i ati i 4 fëmijëve, ka të kryer shkollën e mesme, punon si kamerier, i gjendjes së mesme ekonomike, i padënuar më parë.

II. I akuzuari **F. K.** nga i ati H. dhe e ëma V. e lindjes K., i lindur më ..., në fshatin M., Komuna e Malishevës, tani jeton në I., me nr. personal, shqiptar, shtetas i R. së Kosovës, i martuar, i ati i 2 fëmijëve, ka të kryer shkollën fillore, punëtor, i pa dënuar më parë, i gjendjes së mesme ekonomike.

III. I akuzuari **E. K.** nga i ati S. dhe e ëma N. e lindjes B., i lindur më, në fshatin M., Komuna e Malishevës, tani jeton në Gj., me nr. personal ..., shqiptar, shtetas i R. së Kosovës, i martuar, i ati i tre fëmijëve, ka të kryer shkollën e mesme, punëtor, i pa dënuar më parë, i gjendjes së mesme ekonomike.

PJESA PËRSHKRUESES PËR: N. K., F. K. DHE E. K..

**TË AKUZUARIT: N. K., N. K., F. K.
DHE E. K.,**

JANË FAJTORË

Sepse,

I. Më datën 15.08.2018 rreth orës 12:00/h, në M. në Rr. "S.", pikërisht tek Restorant "V." me dashje përdorë forcën, në atë mënyrë që ditën kritike i dëmtuari N. M. ishte me nipin e tij M. J. me veturën e tyre në M. për disa punë dhe që të dy kanë dashur ta parkojnë makinën për të fotokopjuar disa dokumente dhe për të pirë kafe dhe i dëmtuari N. ka shkuar ta parkojë makinën dhe pasi që e ka parkuar makinën ka vërejtur se nipi i tij M. ishte duke u fjalosur me të pandehurin N. K. dhe i njëjti N.M. ka ndërhyrë që ti ndajë dhe më pastaj kanë dale nga restoranti edhe djemtë e axhës së N. K.: N. K., F. K. dhe E. K., ku aty ka filluar përleshja dhe gjatë përleshjes të dëmtuarit M. J. i kanë shkaktuar lëndime të lehta trupore sipas ekspertizës mjeko – ligjore e dt. 13.09.2018 e Dr. M. G..

- me çka kanë kryer veprën penale lëndim i lehtë trupor në bashkëkryerje nga neni 188 par.1 nën par.1.4 lidhur me nenin 31 të KPRK-së (Kodi nr.04/L-082).

**TË AKUZUARIT: N. K., N. K., F. K.
DHE E.K.,**

JANË FAJTORË

Sepse,

II. Më datën 15.08.2018 rreth orës 12:00/h, në Malishevë në Rr. "S.", pikërisht tek Restorant "V." me dashje përdorë forcën, në atë mënyrë që ditën kritike i dëmtuari N. M. ishte me nipin e tij M. J. me veturën e tyre në M. për disa punë dhe që të dy kanë dashur ta parkojnë makinën për të fotokopjuar disa dokumente dhe për të pirë kafe dhe i dëmtuari N. ka shkuar ta parkojë makinën dhe pasi që e ka parkuar makinën ka vërejtur se nipi i tij M. ishte duke u fjalosur me të pandehurin N. K. dhe i njëjti N. M. ka ndërhyrë që ti ndajë dhe më pastaj kanë dale nga restoranti edhe djemtë e axhës së N.K.: N. K., F. K. dhe E. K., ku aty ka filluar përleshja dhe gjatë përleshjes të dëmtuarit N. M. i kanë shkaktuar dhimbje.

- me çka kanë kryer veprën penale sulm në bashkëkryerje nga neni 184 par.1 e lidhur me nenin 31 të KPRK-së (Kodi nr.06/L-074).

Gjykata me aplikimin e neneve: 4,6,7,17,41,42,43,46,46par.3,73,74,188 par.1 nën par.1.4 lidhur me nenin 31 të KPRK-së (Kodi nr.04/L-082), dhe neneve: 3,4,6,7,17,21,38,39,40,43,69,70,184 par.1 e lidhur me nenin 31 të KPRK-së (Kodi nr.06/L-074), si dhe neneve 359 par.2, 365, 450, të KPPK-së, të akuzuarit: **N.K., F. K. DHE E. K. i,**

PJESA DËNUESE PËR N. K.,

IA CAKTON

Për veprën e parë penale, me çka kanë kryer veprën penale lëndim i lehtë trupor në bashkëkryerje nga neni 188 par.1 nën par.1.4 lidhur me nenin 31 të KPRK-së (Kodi nr.04/L-082), të përshkruar në piken **I-re** të këtij aktgjykimi, e dënon me dënim me gjobë në shumën prej dyqind (200) euro,

Për veprën e dytë penale, me çka kanë kryer veprën penale sulm në bashkëkryerje nga neni 184 par.1 e lidhur me nenin 31 të KPRK-së (Kodi nr.06/L-074), të përshkruar në piken **II-te** të këtij aktgjykimi, e dënon me dënim me gjobë në shumën prej dyqind (200) euro,

Në bazë të nenit 80, paragrafi 1 dhe paragrafi 2, nën paragrafi 2.4 të KPRK (Kodi nr.04/L-082), dhe nenit 76, paragrafi 1 dhe paragrafi 2, nën paragrafi 2.4 të KPRK (Kodi nr.06/L-074),

E gjykon

Të akuzuarit **N. K., Gjykata ia cakton dënimin UNIK ME GJOBË** në shumën prej katërqind (400) euro, të cilin dënim është i obliguar që ta paguaj brenda pesëmbëdhjetë (15) ditë nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimit.

Nëse personi i dënuar nuk dëshiron ose nuk mund të paguaj gjobën, gjykata në bazë të nenit 46 paragrafi 3 të KPRK-së (Kodi nr.04/L-082), në bazë të nenit 43 paragrafi 3 të KPRK-së (Kodi nr.06/L-074), dënimin me gjobë do ta zëvendësoj me dënim burgimi në kohëzgjatje prej njëzet (20) ditësh, duke llogaritur për çdo ditë të qëndrimit në burgim, nga njëzet (20) euro.

PJESA DËNUESE PËR F.K.,

IA CAKTON

Për veprën e parë penale, me çka kanë kryer veprën penale lëndim i lehtë trupor në bashkëkryerje nga neni 188 par.1 nën par.1.4 lidhur me nenin 31 të KPRK-së (Kodi nr.04/L-082), të përshkruar në piken **I-re** të këtij aktgjykimi, e dënon me dënim me gjobë në shumën prej dyqind (200) euro,

Për veprën e dytë penale, me çka kanë kryer veprën penale sulm në bashkëkryerje nga neni 184 par.1 e lidhur me nenin 31 të KPRK-së (Kodi nr.06/L-074), të përshkruar në piken **II-te** të këtij aktgjykimi, e dënon me dënim me gjobë në shumën prej dyqind (200) euro,

Në bazë të nenit 80, paragrafi 1 dhe paragrafi 2, nën paragrafi 2.4 të KPRK (Kodi nr.04/L-082), dhe nenit 76, paragrafi 1 dhe paragrafi 2, nën paragrafi 2.4 të KPRK (Kodi nr.06/L-074),

E gjykon

Të akuzuarit **F.K., Gjykata ia cakton dënimin UNIK ME GJOBË** në shumën prej katërqind (400) euro, të cilin dënim është i obliguar që ta paguaj brenda pesëmbëdhjetë (15) ditë nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimit.

Nëse personi i dënuar nuk dëshiron ose nuk mund të paguaj gjobën, gjykata në bazë të nenit 46 paragrafi 3 të KPRK-së (Kodi nr.04/L-082), në bazë të nenit 43 paragrafi 3 të KPRK-së (Kodi nr.06/L-074), dënimin me gjobë do ta zëvendësoj me dënim burgimi në kohëzgjatje prej njëzet (20) ditësh, duke llogaritur për çdo ditë të qëndrimit në burgim, nga njëzet (20) euro.

PJESA DËNUESE PËR E. K.,

IA CAKTON

Për veprën e parë penale, me çka kanë kryer veprën penale lëndim i lehtë trupor në bashkëkryerje nga neni 188 par.1 nën par.1.4 lidhur me nenin 31 të KPRK-së (Kodi nr.04/L-082), të përshkruar në piken **I-re** të këtij aktgjykimi, e dënon me dënim me gjobë në shumën prej dyqind (200) euro,

Për veprën e dytë penale, me çka kanë kryer veprën penale sulm në bashkëkryerje nga neni 184 par.1 e lidhur me nenin 31 të KPRK-së (Kodi nr.06/L-074), të përshkruar në piken **II-te** të këtij aktgjykimi, e dënon me dënim me gjobë në shumën prej dyqind (200) euro,

Në bazë të nenit 80, paragrafi 1 dhe paragrafi 2, nën paragrafi 2.4 të KPRK (Kodi nr.04/L-082), dhe nenit 76, paragrafi 1 dhe paragrafi 2, nën paragrafi 2.4 të KPRK (Kodi nr.06/L-074),

E gjykon

Të akuzuarit **E. K., Gjykata ia cakton dënimin UNIK ME GJOBË** në shumën prej katërqind (400) euro, të cilin dënim është i obliguar që ta paguaj brenda pesëmbëdhjetë (15) ditë nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimit.

Nëse personi i dënuar nuk dëshiron ose nuk mund të paguaj gjobën, gjykata në bazë të nenit 46 paragrafi 3 të KPRK-së (Kodi nr.04/L-082), në bazë të nenit 43 paragrafi 3 të KPRK-së (Kodi nr.06/L-074), dënimin me gjobë do ta zëvendësoj me dënim burgimi në kohëzgjatje prej njëzet (20) ditësh, duke llogaritur për çdo ditë të qëndrimit në burgim, nga njëzet (20) euro.

Detyrohen të akuzuarit që në emër të kompensimit të viktimave të krimit që secili veç e veç ti paguajnë shpenzimet me nga 30,00 €, shpenzimet e procedurës penale që secili veç e veç ti paguajnë shpenzimet me nga 10,00, si dhe shpenzimet e paushallit gjyqësor që secili veç e veç me nga 30 €, të gjitha këto në afatin prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Të dëmtuarit: M. J. nga fshati L., Komuna e Malishevës; N. K. nga fshati M., Komuna e M.; dhe N.M. nga fshati A. e P., Komuna e D., për realizimin e kërkesave pasurore juridike udhëzohen në kontest civil.

Arsyetimi

Prokuroria Themelore në Gjakovë, në këtë gjykate ka paraqitur aktakuzë PP.nr. 1283/2018, të datës 11.01.2019, kundër të akuzuarve: N. K., N. K., F. K., E. K. që të gjithë nga fshati M., Komuna Malishevë, me çka kanë kryer veprën penale lëndim i lehtë trupor në bashkëkryerje nga neni 188 par.1 nën par.1.4 lidhur me nenin 31 të KPRK-së (Kodi nr.04/L-082) dhe veprës penale me çka kanë kryer veprën penale sulmi në bashkëkryerje nga neni 184 par.1 e lidhur me nenin 31 të KPRK-së (kodi nr.06/L-074), dhe N.M. nga fshati A.e P., Komuna e D., për shkak të veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par. 1 lidhur me paragrafin 4.1 të KPRK-së.

Prokuroria Themelore në Gjakovë ndaj të akuzuarve: N. K., N. K., F. K., E.K., i ka akuzuar për veprat penale: me çka ka kryer veprën penale lëndim i lehte trupor nga neni 188 par. 1 lidhur me paragrafi 4.1 të KPRK-së dhe veprën penale

Prokurori i shtetit pas leximit të aktakuzës deklaroi se: meqenëse janë bërë disa gabime teknike në aktakuzë, bëjë përmirësimin e kualifikimit të dispozitivit të I-rë të aktakuzës, i cili tani e tutje duhet të jetë: “me çka kanë kryer veprën penale lëndim i lehtë trupor në bashkëkryerje nga neni 188 par.1 nën par. 1.4 lidhur me nenin 31 të KPRK-së (Kodi nr.04/L-082), po ashtu bëjë edhe plotësimin e kualifikimit të dispozitivit të II-të të aktakuzës i cili duhet të jetë: “me çka kanë kryer veprën penale sulmi në bashkëkryerje nga neni 184 par.1 e lidhur me nenin 31 të KPRK-së (Kodi nr.06/L-074). Vepra penale e sulmit është kualifikuar me Kodin e ri penal meqenëse në kohën e kryerjes së veprës penale për këtë vepër penale është paraparë dënim me gjobë ose dënim me burg deri në tre vite, ndërsa tani për këtë vepër parashihet dënim me gjobë ose me burgim deri në 1 vit, ku në këtë rast konform nenit 3 të KPRK-së duhet të zbatohet Ligji më i favorshëm për të pandehurin i cili përcakton se: në rast se ligji në fuqi ndryshon para shqiptimit të vendimit të formës së prerë atëherë ndaj kryesit zbatohet ligji që është më i favorshëm, ndërsa pjesa tjetër e aktakuzës mbetet e pandryshuar.

Gjykata pas fillimit të seancës së shqyrtimit fillestar më 10.08.2021, pas përshkrimit të rastit nga gjyqtari se i akuzuari N. K. gjendet në Gj., dhe N. M. në B., Gjykata bene veçimin e lëndës me këtë janë pajtuar: prokurori i shtetit Kastriot Memaj, të akuzuarit: N. K., F. K. dhe E. K., të cilët nuk e kanë kundërshtuar veçimin e procedurës penale, gjeti se në këtë çështje penale duhet të veçohet procedura penale për të akuzuarit: N. K. dhe N. M., për të cilët do të zhvillohet procedurë penale e veçantë pasi që të bëhet sigurimi i prezencës së tyre në gjykatë, gjykata gjeti se në këtë çështje penale duhet të veçohet procedura penale për të akuzuarin N. K. dhe N. M. për të cilin do të zhvillohet procedurë penale e veçante pasi që të behet sigurimi i prezencës së tyre nga gjykate, e cila lëndë ka marrë numrin e ri të lëndës P.nr. 169/2021, sipas aktvendimit P. nr. 10/2019 dt. 10 gusht 2021, ky aktvendim ka ardhur për shkak se: N. K. gjendet në Gj., dhe N. M. në B.. Gjykata për të akuzuarit e dytë, të tretë dhe të pestë ka vazhduar me shqyrtimin fillestar.

Pas deklarimit të pandehurve se ndjehen fajtorë për kryerjen e veprave penale për të cilat akuzohen nga Prokuroria, gjykata me Aktvendim pranoi pranimet e fajësive nga të

pandehurit pasi që është bindur plotësisht se ishin të vetëdijshëm për pasojat e pranimeve të fajësive.

Prokurori i shtetit jep mendimin se nuk e kundërshtoj pranimin e fajësisë meqenëse ky pranim është bërë vullnetarisht, meqenëse të njëjtit paraprakisht nga ana e gjykatës janë njoftuar për pasojat dhe beneficionet e pranimin të fajësisë, po ashtu pranimi i fajësisë gjen mbështetje edhe në shkresat e lëndës që i janë bashkangjitur aktakuzës andaj i propozojmë gjykatës që të pranoj pranimin e fajësisë ndërsa me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit propozoj që si rrethanë lehtësuese të merret pranimi i fajësisë.

I pandehuri N. K., deklarohej i fajshëm për të dyja veprat penale, kërkojë nga gjykata që mundësisht për këto dy vepra penale të më dënoj me gjobë, kjo është hera e parë që i kam kryer këto vepra penale dhe i premtoj gjykatës që nuk do të përsëris vepra tjera penale.

I pandehuri F. K., deklarohej se ndjehem fajtor për të dyja veprat penale, kërkojë nga gjykata që mundësisht për këto dy vepra penale të më dënoj me gjobë kjo është hera e parë që i kam kryer këto vepra penale dhe i premtoj gjykatës që nuk do të përsëris vepra tjera penale.

I pandehuri E. K., deklarohej se ndjehem fajtor për të dyja veprat penale, kërkojë nga gjykata që mundësisht për këto dy vepra penale të më dënoj me gjobë, kjo është hera e parë që i kam kryer këto vepra penale dhe i premtoj gjykatës që nuk do të përsëris vepra tjera penale.

Gjykata gjendjen e këtillë faktike e ka vërtetuar nga vetë pranimet e fajësisë nga të akuzuarit, të cilët në shqyrtimin fillestar vullnetarisht kanë pranuar fajësitë, për shkak të cilës gjykata nuk ka administruar prova, gjatë pranimin të fajësive gjyqtari i vetëm gjykues konstatoi se të akuzuarit kanë kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajit, pranimet janë bërë vullnetarisht nga të akuzuarit. Pranimet e fajit mbështeten në faktet dhe çështjet që përmban aktakuza, në materialet e prezantuara nga Prokurori i shtetit dhe çdo provë tjetër dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike. Gjykata nga të cekurat më lartë ka ardhur në përfundim se në veprimet e të akuzuarve formohen të gjitha elementet e veprave penale të përshkruara si në shqiptim të këtij aktgjykimi dhe për këtë ka vendosur që të akuzuarit ti shpall fajtor dhe ti gjykojë në bazë të ligjit, e më parë duke vërtetuar përgjegjësinë penale juridike të tyre.

Po ashtu nga shkresat e lëndës dhe nga provat materiale siç janë: Raporti fillestar i incidentit nr. ... i datës 15.08.2018; raporti policor mbi marrjen ne pyetje te dyshuarit/ pandehurit N. K. dhënë në Stacionin Policor M. nr. dt. 15.08.2018; raporti policor mbi marrjen ne pyetje te dyshuarit/ pandehurit N. K. dhënë në Stacionin Policor M. nr. ... dt. 15.08.2018; foto dokumentacioni; raporti policor mbi marrjen ne pyetje te dyshuarit/ pandehurit F. K. dhënë në Stacionin Policor M. nr. ... dt. 15.08.2018; raporti policor mbi marrjen ne pyetje te dyshuarit/ pandehurit E. K. dhënë në Stacionin Policor M. nr. ... dt. 15.08.2018; raporti policor mbi marrjen ne pyetje te dyshuarit/ pandehurit N. M. dhënë në Stacionin Policor M. nr. ... dt. 15.08.2018; Qendra Klinike Universitare Qendra Emergjente P. nr. ... dt. 15.08.2018 për N.M.; raporti policor mbi marrjen ne pyetje te dyshuarit/ pandehurit M. J. dhënë në Stacionin Policor M. nr. ... dt. 15.08.2018; foto dokumentacioni; raporti policor mbi marrjen ne pyetje te dëshmitarit – dëmtarit N.

J.dhënë në Stacionin Policor M. nr. ... dt. 15.08.2018; raport i shkurtë nr. ... dt. 15.08.2018; foto dokumentacioni; raporti i oficerit H.K. nr. ... # ... dt. 15.08.2018; Njësia e Forenzikes dt. 15.08.2018; Q. K. M. F. M. raporti mjekësore nr. ... dt. 15.08.2018 për M. J.; Q. K. M. F. M. raporti mjekësore nr. ... dt. 15.08.2018 për N.M.; Q. K. M. F. Malishevë raporti mjekësore nr. ... dt. 15.08.2018 për N. K.; ekspertiza mjeko – ligjore e Dr. M. G. dt. 13.09.2018 për: N.G., N. M. dhe M. J., si dhe shkresat tjera që gjenden në lëndë.

Me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin ndaj të akuzuarve, gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat në kuptim të dispozitave të nenit 73,74 të KPRK-së (Kodi nr.04/L-082), nenit 69,70 të KPRK-së (Kodi nr.06/L-074), të cilat ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimeve, prej rrethanave lehtësuese personale të akuzuarve, se të akuzuarit ne gjykim kanë pasur qëndrime tejet korrekte duke i pranuar fajësitë për veprat penale, i kanë premtuar gjykatës se nuk do të përsëritin vepra të tjera penale, veprat penale i kanë kryer për herën e pare, e sa i përket rrethanave rënduese për të akuzuarit nuk gjeti në përjashtim të këtyre veprave penale për të cilët akuzohen, të akuzuarin e parë, e dytë dhe të akuzuarin e tretë gjykata i dënoi se cilin veç e veç: me dënime unike me gjobë secilin me nga katërqind (400) euro, më këto dënime do të arrihen efektet dhe qëllimet e tyre nga neni 41 të KPRK-së (Kodi nr.04/L-082), nenit 38 (Kodi nr.06/L-074), dhe këto dënime të tilla të shqiptuara sipas bindjes së gjykatës janë në proporcion me veprat penale të kryera dhe me rrethanat personale të cilat i posedojnë te akuzuarit.

Gjykata matjet e dënimeve e bëri me Kodin Penal të Republikës së Kosovës (Kodi nr.04/L-082), dhe Kodin Penal të Republikës së Kosovës (Kodi nr.06/L-074), me arsyetimin se veprat penale janë kryer më dt. 15.08.2018, me ish Kodin Penal të Republikës së Kosovës, ndërsa gjatë seancës vepra e dytë penale është kualifikuar me Kodin e Ri Penal nga Prokurori i shtetit, meqenëse në kohën e kryerjes së veprës penale për këtë vepër penale është paraparë dënim me gjobë ose dënim me burg deri në tre vite, ndërsa tani për këtë vepër parashihet dënim me gjobë ose me burgim deri në 1 vit, ku në këtë rast konform nenit 3 të KPRK-së (Kodi nr.06/L-074), duhet të zbatohet Ligji më i favorshëm për të pandehurin i cili përcakton se: **“në rast se ligji në fuqi ndryshon para shqiptimit të vendimit të formës së prerë atëherë ndaj kryesit zbatohet ligji që është më i favorshëm”**, për këtë arsye se matja e dënimeve është bërë me: 1. Kodin Penal të Republikës së Kosovës (Kodi nr.04/L-082); dhe 2. Kodin Penal të Republikës së Kosovës (Kodi nr.06/L-074).

Vendimi për shpenzimet e procedurës penale dhe paushallit gjyqësor janë marr bazuar në nenin 450 par. 1 dhe 2 nën par. 2.6 të KPPK-së, si dhe bazuar në nenin 39 par. 3 nën par. 3.2 te Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit nr. 05/L-036.

Vendimi për udhëzimin e palëve të dëmtuara në kontest civil është marrë në bazë të nenit 463 par 2 të KPPK-së.

Ne kuptim te nenit 365 te KPPK-së u vendos si ne dispozitiv te këtij Aktgjykimi

**GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË/ DEGA NË MALISHEVË
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI PENAL**

P.nr.10/2019, Datë 13 gusht 2021

**Zyrtarja ligjore,
Albane MORINA**

**Gjyqtari i vetëm gjykues,
Njazi MORINA**

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, llogaritur nga dita e pranimit të tij. Ankesa dorëzohet përmes kësaj Gjykate, në kopje të mjaftueshme për palët dhe gjykatën.